

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SHOQËRIA " BRAHIMLLARI KONSTRUKSION " SH.P.K.

Në Tiranë, sot më datë 11.11.2019, në cilësinë e ortakëve themelues së Shoqërisë " **BRAHIMLLARI KONSTRUKSION** " sh.p.k, shtetasit:

- **ENGJELL BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 10.04.1964, lindur në Thumanë, Krujë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024446590 / Nr. Personal G40410292B;
- **NEVRUZ BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 30.07.1960 lindur në Mazrek, Korçë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024470393 / Nr. Personal G00730101T;
- **VALBON BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 08.11.1968, lindur në Thumanë, Krujë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024472461 / Nr. Personal G81108032E;
- **YLLI BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 29.01.1958, lindur në Mazrek, Korçë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024446871 / Nr. Personal F801129100G;

... me vullnet të lirë, të plotë dhe të pavesuar, bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, hartojnë këtë Statut të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin "**BRAHIMLLARI KONSTRUKSION** " sh.p.k, (më poshtë e quajtur "Shoqëria").


KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Krijimi

1. Shoqëria "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k, është person juridik i së drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").
2. Shoqëria "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k, është krijuar sipas Aktit të Themelimit, datë 11.11.2019, nga ortakët themelues, shtetasit:

- **ENGJELL BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 10.04.1964, lindur në Thumanë, Krujë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024446590 / Nr. Personal G40410292B;
- **NEVRUZ BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 30.07.1960 lindur në Mazrek, Korçë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024470393 / Nr. Personal G00730101T;
- **VALBON BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 08.11.1968, lindur në Thumanë, Krujë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024472461 / Nr. Personal G81108032E;



- **YLLI BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 29.01.1958, lindur në Mazrek, Korçë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024446871 / Nr. Personal F801129100G;

Neni 2

Personaliteti Juridik

1. Shoqëria "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e cila ushtron aktivitetin e saj tregtar në përputhje me këtë Statut dhe rendin juridik në Republikën e Shqipërisë.
2. Shoqëria "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k, është titullare e të drejtave subjektive dhe mbajtëse e detyrimeve juridike.
3. Ortakët përgjigjet personalisht për detyrimet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Çdo ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Objekti i Veprimtarisë

3.1 "Projektimi dhe zbatimi i veprave ndërtimore si vijon: ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime, gërmime dhe sistemime dheu, tracime, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndërtime rrugësh, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik si hapje kanalizimesh, ndërtim ujësjellësish etj.

Prodhim me shumice dhe pakice te materialeve inerte si beton, asfalto-beton etj. Shtrime rrugësh dhe riparime me beton , asfalto-beton etj. Ndërtim dhe shtrirje te rrjeteve te gazit natyror. Zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve per rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale. Sigurimi i projekteve industrial ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata për lëvrime dhe mbi bazën e këtij rifinancimi dhe kreditimi. Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve te ndërtimit, import-eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari te vete shoqërisë si dhe te tretëve ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, qelqere etj. Tregtim me shumice dhe pakice e çdo lloj pajisjeje dhe makinerive qe përdoren ne fushën e ndërtimit. Import – eksport torse. Hapjen e zyrave , organizimin e kurseve dhe mbajtjen e seminareve me qellim zbatimin e rregullave te sigurimit teknik ne fushën e ndërtimeve ne përputhje me legjislacionin shqiptar dhe normat e Komunitetit European. Tregtim me shumice dhe pakice i mallrave ushqimore, industrial, elektrike etj . Prodhimi I mallrave ushqimore dhe industrial dhe i lendes se pare për to ne vend si dhe kontraktimi per këtë qellim. Veprimtari ne fushën e transportit te mallrave brenda dhe jashte vendit me mallra te vete shoqërisë dhe te te tretëve. Tregtimi me shumice dhe pakice I konfeksioneve për burra dhe gra te te gjitha llojeve te veshjeve etj. Tregtimi me shumice dhe pakice I pijeve alkolike artikuj prej druri etj. Tregtimin e karburanteve te ndryshme me pakice si vajra lubrifikant gazit te lëngshëm etj. Dhënia e konsulencave juridike, ndërmjetësim ne lidhjen e marrëveshjeve midis palëve dhe te treteve, shërbime të ndryshme komisionare, përfaqësime etj

3.2 Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër nevojshëm ose të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3.3 Shoqëria mund të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me kompani apo persona fizik që operojnë në fushën e saj apo fusha të tjera.

3.4 Shoqëria do të ofrojë shërbime për persona fizik dhe juridik, privat apo shtetëror, vendas apo të huaj.



2

Neni 4

Selia

1. Selia e Shoqërisë "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k, do të jetë në adresën: Rruga "Violeta Manushi", Nr. Pasurie 76/173+1-16, vol 22, fq.109, Zk.3976, Apartament me sipërfaqe 117.03 m², Njësia Bashkiake Nr.3, Kodra e priftit, Shkoze, Tiranë, Shqipëri.

2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 5

Kohëzgjatja

1. Shoqëria "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

2. Shoqëria mund të shpërndahet përpara këtij afati vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 107,930,160.00 (një qind e shtatë milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind lekë);

2. Kapitali themeltar i Shoqërisë është tërësisht në natyrë. (neni 68/5 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar "Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve").

3. Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 4 (katër) Kuota të nënshkruara nga Ortakët themelues. Kuotat shlyhen nga Ortakët, tërësisht në natyrë, duke kaluar në pronësi të Shoqërisë, (hequr dorë nga pronësia në favor të Shoqërisë) mbi pasuritë e paluajtshme me të dhëna, si më poshtë vijon:

- Pasuria Nr. 76/173+1-3, Vol. 22, Faqe 96, ZK 3976, Apartament me sip. 104.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002797 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-7, Vol. 22, Faqe 100, ZK 3976, Apartament me sip. 104.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002791 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-8, Vol. 22, Faqe 101, ZK 3976, Apartament me sip. 99.90 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002805 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-5, Vol. 22, Faqe 98, ZK 3976, Apartament me sip. 56.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002787 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-10, Vol. 22, Faqe 103, ZK 3976, Apartament me sip. 99.90 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002798 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.



- Pasuria Nr. 76/173+1-1, Vol. 22, Faqe 94, ZK 3976, Apartament me sip. 99.90 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002783 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-15, Vol. 22, Faqe 108, ZK 3976, Apartament me sip. 104.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002803 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-14, Vol. 22, Faqe 107, ZK 3976, Apartament me sip. 99.90 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002802 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-11, Vol. 22, Faqe 104, ZK 3976, Apartament me sip. 104.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002799 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-12, Vol. 22, Faqe 105, ZK 3976, Apartament me sip. 99.90 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002800 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-2, Vol. 22, Faqe 95, ZK 3976, Apartament me sip. 104.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002784 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-13, Vol. 22, Faqe 106, ZK 3976, Apartament me sip. 104.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002801 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-6, Vol. 22, Faqe 99, ZK 3976, Apartament me sip. 99.90 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002790 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.
- Pasuria Nr. 76/173+1-9, Vol. 22, Faqe 102, ZK 3976, Apartament me sip. 104.04 m², në adresën Shkozë, sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. 2002796 Serie, datë 07.11.2019 Z.V.R.P.P DR Rurale 1.

4. Në mbështetje të nenit 193/d të Kodit Civil, *(Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme: (...) d) aktet me të cilat krijohet një shoqëri ose një subjekt tjetër i së drejtës që ka në pronësi pasuri të paluajtshme ose gëzon të drejta të tjera reale mbi to;)* ky Statut dhe Akti i Themelimit të Shoqërisë "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k do të regjistrohen në përputhje me ligjin pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

5. Në mbështetje të nenit 68/6 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, ku parashikohet se *"Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para"*, Ortakët Themelues të Shoqërisë "Brahimllari Konstruksion" sh.p.k, kontributet në natyrë të secilit prej tyre, me marrëveshje i kanë vlerësuar si më poshtë:

- **Z. ENJELL BRAHIMLLARI**, zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë të kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë ALL 26,982,540.00 (njëzet e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy lekë);
- **Z. NEVRUZ BRAHIMLLARI**, zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë të kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë ALL 26,982,540.00 (njëzet e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy lekë);
- **Z. VALBON BRAHIMLLARI**, zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë të kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë ALL 26,982,540.00 (njëzet e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy lekë);

- **Z. YLLI BRAHIMLLARI**, zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë të kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë ALL 26,982,540.00 (njëzet e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy lekë);

6. Kontributet e tjera të ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

7. Ortakët përgjigjet për humbjet e Shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe/ose me anë të kontributeve në natyrë apo në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

2. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

3. Vendimi për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Neni 8

Transferimi i Kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë "BRAHIMLLARI KONSTRUKSION" sh.p.k dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, Kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Në rast shitje të kuotave, ortaku që shet kuotën duhet të respektojë të drejtën e parablerjes së ortakëve ekzistues. Vetëm nëse ortaku ose ortakët ekzistues nuk dëshirojnë të blejnë kuotën atëherë ajo mund t'i shitet palëve të treta.

4. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

5. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 9

Organi Vendimmarrës

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të parashikuar në këtë statut, ushtrohen në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

3. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo



ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

4. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë edhe për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

5. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

6. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, nga ligje të tjera që lidhen me aktivitetin tregtar të shoqërisë, dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
2. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori e Shoqërisë.

Neni 11

Procesverbalet e Mbledhjes së Asamblesë

6



1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbalit duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 12

Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratori i parë i Shoqërisë "BRAHIMLLARI KONSTRUKSION" sh.p.k, i zgjidhur për një afat 5 (pesë) vjeçar është shtetasi:
 - **YLLI BRAHIMLLARI**, i biri i Çerçiz-it, i datëlindjes 29.01.1958, lindur në Mazrek, Korçë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 024446871 / Nr. Personal F801129100G;
3. Administratorët e tjerë të Shoqërisë emërohen dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas parashikimeve të Prg.1, të këtij neni.

Neni 13

Kompetencat e Administratorëve

1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
 - a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryej regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
2. Administratori ka të drejtë të kryej të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve, bankave të të gjitha niveleve etj.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat.

Neni 14

Përgjegjësitë e Administratorëve

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, administratori detyrohet:
 - a) të kryej detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi;
 - b) të ushtroj kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësoj me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandaloj dhe mënjanoj rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtroj detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
 - d) japin kredi.

KREU IV

VITI FINANCIAR DHE EKSPERTËT

Neni 15



Viti Financiar

1. Viti financiar i Shoqërisë "BRAHIMLLARI KONSTRUKSION" sh.p.k fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 16

Ekspertët Kontabël

1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që ti paraqesë e dorëzojë në kohë administratorit të Shoqërisë.
3. Raporti i ekspertit miratohet në mbledhjen më të afërt të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17

Bilanci i Shoqërisë dhe Dividendët

1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
2. Asambleja e Përgjithshme, vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji specifik.

Neni 18

Të ardhurat neto (dividendi) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i'u mbeten dhe i'u kalojnë në pronësi, ortakëve të Shoqërisë.

KREU IV

PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 19

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
 - a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) me vendim të gjykatës;
2. Prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentim.
3. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
4. Çdo dokument i nxjerrë nga likuiduesi shoqërohet nga emërtesa "Shoqëri në Likuidim e Sipër".

Neni 20



1. Likuidimi i Shoqërisë kryhet në përputhje me parashikimet e neneve 190-205 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

Neni 21

Riorganizimi i Shoqërisë

1. Shoqëria "BRAHIMLLARI KONSTRUKSION" sh.p.k mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.
2. Riorganizimi i Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Neni 22

Referenca Ligjore

1. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Kodi Civil dhe çdo ligj tjetër specifik që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe që lidhet me veprimtarinë tregtare të Shoqërisë.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe ortakëve, midis ortakëve, midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente Gjykatat Shqiptare.

Neni 24

Dispozita e Fundit

1. Ky Statut u redaktua nga ortakët themelues të Shoqërisë "BRAHIMLLARI KONSTRUKSION" sh.p.k në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë juridike.

ORTAKËT

E

SHOQËRISË "BRAHIMLLARI KONSTRUKSION" SH.P.K

ORTAKËT THEMELUES

ENGJELL BRAHIMLLARI



NEVRUS BRAHIMLLARI



VALBON BRAHIMLLARI



YLLI BRAHIMLLARI

